



GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E FAMILJEVE NË SHQIPËRI

Gjashtëmuji i parë, 2020

**BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR**

Gusht, 2020

PERMBAJTJA

Përmbledhje e gjetjeve kryesore të Vrojtimit mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e Familjeve	3
Karakteristikat demografike dhe financiare të familjeve të intervistuar 4	4
Huamarrja e familjeve..... 6	6
Ngarkesa në borxh e familjeve..... 11	11
Pasuria e familjeve..... 13	13

Përmbledhje e gjetjeve kryesore të Vrojtimit mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e Familjeve

Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së familjeve kryhet që prej vitit 2010, me frekuencë gjashtëmujore. Për shkak të pandemisë së SARS-CoV-2, vrojtimi është hedhur në terren gjatë muajit korrik 2020, duke përdorur forma të ndryshme për mbledhjen e informacionit, në respektim të masave parandaluese për të minimizuar përhapjen (intervista në distancim fizik, postë elektronike dhe telefon). Ky vrojtim mbulon zhvillimet mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e familjeve për gjashtëmujorin e parë 2020, si edhe pritshmëritë e tyre për gjashtëmujorin e dytë të vitit. Ai është kryer mbi një kampion rastësor prej 1210 familje, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin.

▪ GJENDJA FINANCIARE

Numri total i të punësuarve në kampionin e vrojtuar ka shënuar një rritje të lehtë krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por ka rezultuar në rënie krahasuar me një vit më parë dhe kjo ka ardhur nga të tre kategoritë e të punësuarve (sektor shtetëror, privat dhe të vetëpunësuar), por më e theksuar në rastin e sektorit shtetëror. Niveli i përgjithshëm i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve ka shënuar një rritje modeste gjatë periudhës së vrojtuar, por kanë rezultuar në rënie krahasuar me një vit më parë.

▪ HUAMARRJA

Rreth 23% e familjeve të përgjigjura (ose 251 familje), deklarojnë se kanë hua për të paguar në momentin e intervistimit, pavarësisht llojit, burimit apo vlerës së kësaj huaje. Kjo peshë ka rënë me 1 pp respektivisht krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe me një vit më parë, duke vijuar të mbetet nën mesataren historike të vrojtimit prej rreth 28%. *Totali i tepricës së raportuar të huasë në kampionin e vrojtuar, ka rezultuar në rritje krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë.* Rreth 63% e tepricës është siguruar nga 'burime formale' ('bankat' dhe 'institucione financiare jobankare') dhe 37% nga 'burime joformale' ('persona fizikë' dhe 'hua në formë malli'). Kjo strukturë është zhvendosur në favor të huamarrjes nga burime joformale krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë, si rezultat i rritjes së tepricës së huasë nga burime joformale më shumë se rritja e tepricës nga burimet formale. Sipas qëllimit të përdorimit të huasë, rezulton se rreth 73% e saj është përdorur për 'blerjen/riparimin e një prone', duke shënuar një rritje të ndjeshme në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë. Nga ana tjetër, rreth 18% e tepricës është përdorur për 'zhvillimin e një biznesi' dhe 2% për qëllime 'konsumi' dhe të dy këto pesha kanë rezultuar në rënie.

▪ NGARKESA NË BORXH

Shumica e familjeve huamarrëse (80% e familjeve huamarrëse të përgjigjura) deklarojnë që *kësti i huasë* nuk ka ndryshuar gjatë gjashtëmujorit të vrojtuar. *Balanca neto* e pjesës tjetër të përgjigjeve tregon për rritje të kështu gjatë periudhës. Rreth 55% e familjeve huamarrëse deklarojnë se aftësia e tyre paguese nuk ka ndryshuar, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të përgjigjeve tregon për përkëqesim të aftësisë së tyre paguese, si në krahasim me gjashtëmujorin kaluar dhe në krahasim me një vit më parë, çka mund të jetë reflektim i përkëqesimit të parametrave ekonomikë në vend për shkak të pandemisë së Covid-19. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020, rreth 66% e familjeve nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese, ndërsa *balanca neto e pjesës tjetër të përgjigjeve tregon për pritje pesimiste.* *Indeksi i marrjes/rimarrjes së një huaje në 6 muajt e ardhshëm* ka shënuar rritje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar me një vit më parë. Kjo mund të sinjalizojë një rritje të kërkesës së familjeve për huamarrje gjatë gjysmës së dytë të vitit 2020.

▪ PASUARIA E FAMILJEVE

Rreth 93% e familjeve (total i kampionit të intervistuar) 'zotërojnë 1-2 prona të patundshme', kryesisht shtëpi banimi dhe kjo peshë ka rënë me 1 pp krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe me 4 pp krahasuar me një vit më parë; 2% deklarojnë se 'zotërojnë më shumë se 2 prona të patundshme', (shtëpi dhe tokë/dyqan etj.) dhe 5% kanë deklaruar se 'nuk zotërojnë asnjë pronë'. Në grupin e familjeve që kanë deklaruar pasuri financiare, rezulton se *depozitat dhe/ose llogaritë bankare* vijnë të mbeten lloji kryesor i investimit financiar, si në rastin e totalit të familjeve (62% e rasteve të raportuara) dhe në rastin e familjeve huamarrëse (77% e rasteve). *Këto pesha kanë rezultuar në rënie krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë.*

1 -Karakteristikat demografike dhe financiare të familjeve të intervistuar


Karakteristikat e kampionit. Vrojtimi i radhës është kryer mbi kampionin rastësor prej 1210 familjesh, ku rreth 89% e tyre (1079 familje) kanë marrë pjesë në procesin e intervistimit duke iu përgjigjur plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të pyetësorit. Pësia e të përgjigurve ndaj totalit të kampionit ka mbetur e pandryshuar krahasuar me vërtetimin e kaluar. Në totalin e familjeve të përgjigjura, rezultojnë se rreth 46% banojnë në zonat urbane dhe 54% në zonat rurale të vendit.

Analiza në vijim i referohet vetëm familjeve që kanë dhënë përgjigje për secilën pyetje dhe të gjitha llogaritjet janë bërë mbi bazën e totalit të të përgjigurve.

1.1-Punësimi dhe burime të tjera të ardhurash. Numri total i anëtarëve të familjeve që sigurojnë të ardhura nga punësimi/vetëpunësimi në sektor shtetëror, privat dhe/ose burime të tjera¹, ka shënuar një rritje të lehtë (me 1.1 %) në terma gjashtëmujorë (6MII 2019), por rënie me 2.1% në terma vjetorë (6MI 2019).

Grafik 1.1 Shpërndarja e personave që sigurojnë të ardhura sipas llojit të burimit

(në% ndaj totalit të personave që sigurojnë të ardhura)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Zëri 'Tjetër' përmbledh kryesisht rastet e personave që marrin asistencë invaliditeti, ndihmë nga të afërm dhe ata që bëjnë punë të rastit.

Duke e fokusuar analizën vetëm në pjesën e të punësuarve² të kampionit të vërtetuar (Tabelë 1.1), numri total i tyre gjithashtu ka shënuar një rritje të lehtë (me 1.7%) në terma gjashtëmujorë, por ka rezultuar në rënie (me 4.2%) në terma vjetorë, e ardhur nga të tre sektorët e punësimit, por më e theksuar në rastin e punësimit në sektorin shtetëror.

¹Në pyetësor, përveç punësimit në sektorët shtetërorë dhe privatë, si burime të ardhurash listohen dhe: 'pension', 'asistencë sociale për papunësi', 'emigracioni' dhe zëri 'tjetër', ku përfshihet çdo lloj burimi tjetër që nuk është marrë parasysh në alternativat e dhëna.

²Këtu janë përfshirë vetëm të punësuarit në sektorët shtetërorë, privatë (bujqësorë dhe jobujqësorë) dhe të vetëpunësuar (në sektorin bujqësor dhe jobujqësor).

Tabelë 1.1 Numri i të punësuarve sipas sektorëve

		Shtetëror	Privat	Vetpunësuar	Total të punësuar	Ndr. 6-mujor	Ndr. vjetor
V8	6MI_2014	230 (16%)	567 (40%)	611 (43%)	1408	-5.4%	-8.3%
V9	6MII_2014	227 (17%)	502 (38%)	600 (45%)	1329	-5.6%	-10.7%
V10	6MI_2015	270 (19%)	495 (35%)	654 (46%)	1419	6.8%	0.8%
V11	6MII_2015	268 (18%)	528 (36%)	657 (45%)	1453	2.4%	9.3%
V12	6MI_2016	283 (18%)	580 (37%)	691 (44%)	1554	7.0%	9.5%
V13	6MII_2016	272 (18%)	609 (40%)	633 (42%)	1514	-2.6%	4.2%
V14	6MI_2017	333 (21%)	575 (36%)	672 (43%)	1580	4.4%	1.7%
V15	6MII_2017	317 (21%)	595 (38%)	634 (41%)	1546	-2.2%	2.1%
V16	6MI_2018	259 (17%)	592(38%)	705 (45%)	1556	0.6%	-1.5%
V17	6MII_2018	280 (18%)	618(39%)	682 (43%)	1580	1.5%	2.2%
V18	6MI_2019	266 (18%)	623 (41%)	613 (41%)	1502	-4.9%	-3.5%
V19	6MII_2019	235 (17%)	574 (41%)	606 (43%)	1415	-5.8%	-10.4%
V20	6MI_2020	233 (16%)	621 (43%)	585 (41%)	1439	1.7%	-4.2%


Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Shënim: Shifrat në kllapa janë peshat e secilit zë në raport me totalin e të punësuarve.

Numri i familjeve që kanë deklaruar dhe **burime të tjera të qëndrueshme të ardhurash**³ (si qira, interesa bankare etj.) ka rezultuar 10% (ose gjithsej 107 familje), duke shënuar rritje me 1 pp gjatë periudhës. Në këtë grup familjesh, rreth 56% e tyre deklarojnë si burime alternative të ardhurash 'interesat nga kursimet (depozita, bono thesari etj.)', 17% deklarojnë të ardhura nga 'qiradhënia e pronave' dhe 9% deklarojnë kombinim burimesh, kryesisht nga qiradhënia dhe interesat nga kursimet.


1.2-Të ardhurat dhe shpenzimet e familjeve. Gjatë 6-mujorit në analizë, struktura e shpërndarjes së familjeve sipas nivelit të të ardhurave është zhvendosur disi drejt nivelit mesatar ('50-100 mijë lekë') duke rezultuar respektivisht në 28% të familjeve (në rritje me 2 pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar). Nga ana tjetër, rreth 11% e tyre deklarojnë të ardhura të ulëta mujore 'deri në 17 mijë lekë', 55% deklarojnë të ardhura mujore '50-100 mijë lekë' dhe 5% deklarojnë të ardhura në nivelin '100-200 mijë lekë' (Grafik 1.2).

Grafik 1.2 Shpërndarja e familjeve sipas nivelit mujor të të ardhurave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 1.3 Shpërndarja e familjeve sipas nivelit mujor të shpenzimeve



³ Në këtë pyetje, alternativat e listuara si burime të qëndrueshme të ardhurash janë: (1) qira, (2) interesa nga kursimet (depozita, bono thesari etj.), (3) interesa nga para të dhëna hua të tretëve, (4) tjetër (përcakto).

Në shpërndarjen e familjeve sipas nivelit të shpenzimeve të domosdoshme të jetesës rreth 53% e tyre deklarojnë shpenzime mujore në nivelin '20-50 mijë lekë' dhe kjo peshë ka rënë 4 pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar, ndërkohë që rreth 20% deklarojë shpenzime në nivelin '10-20 mijë lekë' dhe kjo peshë është rritur gjatë periudhës me 3 pp. (Grafik 1.3).

Indeksi i të ardhurave⁴ dhe **Indeksi i shpenzimeve**⁵ kanë shënuar një rritje të lehtë gjatë periudhës së vrojtuar, ku rritja e indeksit të të ardhurave duket disi më e theksuar. Nga ana tjetër, të dy indeksat rezultojnë në rënie në terma vjetorë. Kjo ecuri e të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve, mund të jetë reflektim i fillimit të materializimit të rënies ekonomike në vend gjatë këtij viti si pasojë e dy goditjeve të forta, tërmetit të nëntorit të vitit të kaluar dhe pandemisë Covid-19.

Grafik 1.4 Indekset e të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve (2010=100)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Euroizimi i të ardhurave të familjeve shqiptare vijon të mbetet i ulët, ku vetëm 15% e tyre (163 familje në 1073 familje të përgjigjura) deklarojnë se kanë të ardhura në valutë (kryesisht në euro) në raporte të ndryshme ndaj totalit të të ardhurave mujore⁶. Kjo peshë ka shënuar një rritje të lehtë me 1 pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë.

2- Huamarrja e familjeve

Në këtë vrojtim, numri i familjeve që deklarojnë se kanë një ose më shumë hua për të paguar në momentin e intervistimit, pavarësisht llojit, burimit apo vlerës së kësaj huaje, ka rezultuar në 251 familje ose rreth 23% e të përgjigjurve (Grafik 2.1) Kjo peshë ka rënë me 1 pp respektivisht krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë, duke vijuar të mbetet nën mesataren historike të vrojtimit prej rreth 28%.

⁴ 'Indeksi i të ardhurave' është ndërtuar si shumë e peshuar e frekuencave në % të përgjigjeve me koeficientët e përcaktuar për çdo interval si në vijim: 'deri në 17 mijë lekë' me 0.2; '17-50 mijë lekë' me 0.4; '50-100 mijë lekë' me 0.6; '100-200 mijë lekë' me 0.8; dhe 'mbi 200 mijë lekë me 1'. Vlerat e marra për çdo vit janë kthyer në indeks me bazë vitin 2010 = 100. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton rritje të nivelit të të ardhurave mujore.

⁵ 'Indeksi i shpenzimeve' është ndërtuar si shumë e peshuar e frekuencave në % të përgjigjeve me koeficientët e përcaktuar për çdo interval si në vijim: 'deri në 10 mijë lekë' me 0.2; '10-20 mijë lekë' me 0.4; '20-50 mijë lekë me 0.6'; '50-100 mijë lekë me 0.8' dhe 'mbi 100 mijë lekë' me 1. Vlerat e marra për çdo vit janë kthyer në indeks me bazë vitin 2010 =100. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton rritje të nivelit të shpenzimeve të domosdoshme mujore.

⁶ Alternativat e lidhura me nivelin e të ardhurave në monedha të huaj janë: (1)'nuk kam fare', (2) 'deri në 10%', (3)'10-50%' dhe (4)'mbi 50%'.

Analiza në vijim i referohet vetëm grupit të familjeve huamarrëse⁷.

2.1-Niveli i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve huamarrëse. Gjatë gjashtëmujorit të vrojtuar, struktura e shpërndarjes së familjeve huamarrëse sipas të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara prej tyre, është përqendruar disi drejt nivelit mesatar të të ardhurave (prej '50-100 mijë lekë') dhe një niveli më të ulët shpenzimesh mujore ('deri në 10 mijë lekë'). Konkretisht, shpërndarja e huamarrësve sipas të ardhurave rezulton më e përqendruar në nivelin '17-50 mijë lekë' (51% e huamarrësve), në rënie me 3 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe në nivelin '50-100 mijë lekë' (32% e huamarrësve), në rritje me 4 pp gjatë periudhës. Nga ana tjetër, shpërndarja e huamarrësve sipas shpenzimeve (mujore) të domosdoshme të jetesës rezulton më e përqendruar në nivelin '20-50 mijë lekë në muaj' (57% e huamarrësve), dhe në nivelin '10-20 mijë lekë në muaj', të dyja respektivisht në rënie me 1.2 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe në nivelin '100-200 mijë lekë', pothuaj e pandryshuar gjatë periudhës.

Shpërndarja e mësipërme e familjeve huamarrëse sipas nivelit mujor të të ardhurave/shpenzimeve, ka rezultuar në rritje të vlerave të indeksit të të ardhurave dhe rënie të indeksit të shpenzimeve të tyre gjatë periudhës (Grafik 2.2), duke sjellë një përmirësim të balancës financiare (të ardhura-shpenzime) të këtyre familjeve.

Grafik 2.1 Indeksi i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjes huamarrëse
(2010 = 100)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.2-Qëllimet e huamarrjes. Qëllimet kryesore të huamarrjes mbeten: 'për konsum' në 32% të rasteve të huamarrjes, 'për blerje/riparim i një prone' në 36% të rasteve dhe për 'zhvillim biznesi' në 10% të rasteve. Pësia e rasteve të huamarrjes për 'blerje/riparim prone' ka rezultuar në rritje me 6 pp gjatë gjashtëmujorit të vrojtuar dhe në rritje me 8 pp krahasuar me një vit më parë, duke vijuar në prirjen e vënë re në dy vitet e fundit. Nga ana tjetër huamarrja për 'zhvillim biznesi' dhe për 'konsum' kanë rezultuar në rënie si në terma gjashtëmujorë (respektivisht me 2 pp) dhe në terma vjetorë (respektivisht me 10 pp dhe 1 pp).

⁷ Shënim metodologjik: meqë një familje mund të ketë më shumë se një hua për të paguar në periudhën referuese me karakteristika të ndryshme (burimi, qëllimi etj), për të mos humbur informacionin, në këtë rubrikë, llogaritjet janë bërë mbi 'totalin e rasteve të huamarrjes' të deklaruara, përveçse kur specifikohet '...mbi totalin e huamarrësve (në këtë vrojtim = 251 familje). Me 'raste huamarrje' nënkuptojmë totalin e huave të marra nga e njëjta familje dhe më të njëjtën karakteristikë, p.sh.: një familje që deklaron 2 hua të marra nga banka përbën '1 rast huamarrje nga banka' dhe një familje që ka një hua nga banka dhe një nga një person fizik, përbën '1 rast huamarrje nga banka' dhe '1 rast huamarrje nga persona fizikë'.


Grafik 2.2 Huamarrja sipas QËLLIMIT të përdorimit të huasë
(në % ndaj totali të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


2.3-Teprica e huasë. Duke e analizuar tepricën e deklaruar sipas burimeve rezultojnë se rreth 63% e saj sigurohet nga burime formale (62% nga bankat dhe 1% nga institucione financiare jobankare) dhe rreth 37% nga burime joformale ('persona fizikë' dhe 'hua në formë malli'). Kjo strukturë është zhvendosur në favor të huamarrjes nga burime joformale si krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar (me 11 pp), ashtu edhe krahasuar me një vit më parë (me 8 pp), e ardhur si rezultat i rritjes së tepricës së huasë nga burime joformale me shumë se rritja e tepricës së huasë nga burimet formale (Grafik 2.3). Duke e analizuar tepricën e huamarrjes sipas qëllimit të përdorimit (Grafik 2.4), rezultojnë se rreth 73% e saj është përdorur për 'blerjen/riparimin e një prone', duke shënuar një rritje të ndjeshme me 34 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 36 pp krahasuar me një vit më parë. Sikurse dhe në shpërndarjen e rasteve të huamarrjes, huamarrja për 'blerje/riparim prone' ka shfaqur një prirje të dukshme rritëse gjatë katër vjetërve të fundit. Nga ana tjetër, rreth 18% e tepricës është përdorur për 'zhvillimin e një biznesi' dhe 2% për qëllime 'konsumi' dhe të dy këto pesha kanë rezultuar në rënie, si në terma gjashtëmujorë dhe në terma vjetorë.

Grafik 2.3 Përbërja e tepricës sipas BURIMIT të huasë (në % ndaj totalit të tepricës së deklaruar)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 2.4 Përbërja e tepricës sipas QËLLIMIT të huasë (në % ndaj totalit të tepricës së deklaruar)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim. Zëri "Të tjera" përfshin kryesisht huamarrje për të përballuar shpenzime mjekësore.

2.4-Format e huamarrjes. Në rreth 37% të rasteve të raportuara, huamarrja e familjeve rezulton në formën e 'kredisë nga institucione financiare', ku 33% e rasteve janë në trajtë 'kredie bankare' dhe 4% janë në trajtë 'kartash krediti dhe overdraft'. Në rreth 45% të rasteve, huamarrja deklarohet në formën e 'parasë në dorë', duke shënuar rritje me 3 pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe rritje me 2 pp krahasuar me një vit më parë. Peshë të konsiderueshme vijon të ketë zëri 'mall i papaguar' (rreth 18% e rasteve të huamarrjes), por gjithsesi në rënie krahasuar me vrojtimin e kaluar (me 3 pp) dhe krahasuar me një vit më parë (rënie me 1 pp).

Grafik 2.5 - Huamarrja sipas FORMËS së huasë

(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.5-Pagesa e huasë. Dy format kryesore të pagesës së huasë vijojnë të mbeten pagesat 'me shumë të njëjtë çdo 1/3/6/12 muaj' (50% e rasteve të huamarrjes) dhe 'me shumë të ndryshueshme në periudha të ndryshme' (29% e rasteve të huamarrjes) (Grafik 2.8). Prija e peshës së huamarrjes për këto dy forma pagese ka qenë e kundërt gjatë gjashtëmujorit të vrotuar krahasuar me atë të kaluar, ku në rastin e parë pesha ka rënë me 1 pp, ndërsa në rastin e dytë pesha është rritur 5 pp. Në terma vjetorë, rastet e huamarrjes sipas këtyre dy formave të pagesës, kanë qenë në rritje respektivisht me 19 pp dhe 15 pp.

Grafik 2.6 - Huamarrja sipas MËNYRAVE TË PAGESËS.


(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket ngarkesës së huasë në të ardhurat e familjeve huamarrëse, rreth 71% e tyre deklarojnë se pagesa e huasë zë më pak se 30% të të ardhurave mujore ('deri në 10% të të ardhurave' për 38% të familjeve huamarrëse, '10-30% të të ardhurave' për 33% të familjeve). Nga ana tjetër, rreth 29% të familjeve deklarojnë se kjo pagesë e tejkalon 30% të të ardhurave ('31-50% të të ardhurave' për 18% të familjeve dhe '51-70' për 7% të familjeve dhe 'mbi 70%' për 4% të familjeve).


Grafik 2.7 - Huamarrja sipas raportit 'kësti huasë/të ardhurat totale mujore'
(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.6-Afati i mbetur deri në maturim. Në 67% të rasteve të huamarrjes deklarohet se huaja maturohet 'brenda një viti' dhe kjo peshë është rritur me 4 pp krahasuar me 6-mujorin e kaluar; në 30% të rasteve, afati i mbetur është '1-5 vjet' dhe në 3% të rasteve ka rezultuar 'mbi 5 vjet'. Të dy peshat e fundit kanë rezultuar në rënie si krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë.

Grafik 2.8- Huamarrja sipas MATURIMIT TË MBETUR të huasë
(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.8-Garantimi i huamarrjes. Në 70% të rasteve të huamarrjes rezulton se huaja është 'e pagarrantuar' dhe kjo peshë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe është rritur me 2 pp krahasuar me

një vit më parë. Prirja e kundërt vihet re në ecurinë e rasteve të huamarrjes së garantuar 'me një pronë të familjes'- në rënie në terma gjashtëmujorë (me 3 pp) dhe në terma vjetorë (me 4 pp).

Grafik 2.9 Huamarrja sipas FORMAVE TË GARANTIMIT të huasë
(në % ndaj totali të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Shënim: Zëri "tjetër" përmbledh rastet e huamarrjes së garantuar me forma të tjera, ku më shpesh përmendet garantimi i huasë përmes pagës, garantimit me një mall (si makina) etj.

3- Ngarkesa në borxh e familjeve

Në këtë seksion pyetjesh, familjeve huamarrëse u kërkohet të japin informacion vetëm për *huanë më të madhe* ekzistuese dhe që rëndon më shumë mbi ekonominë e familjes. Si rrjedhojë, peshat e përgjigjeve janë llogaritur mbi totalin e familjeve huamarrëse të përgjigjura për secilën pyetje.

3.1-Ndryshimi i kështit. Rreth 80% e familjeve huamarrëse të përgjigjura kanë deklaruar se kështi i huasë ka mbetur i pandryshuar gjatë 6-mujorit referues. *Balanca neto* e përgjigjeve të pjesës tjetër të familjeve huamarrëse (20% e familjeve huamarrëse) ka rezultuar 1 pp, gjë që tregon për *ritje të kështit gjatë periudhës* dhe krahasuar me një vit më parë.


Grafik 3.1 Ndryshimi i kështit mujor të huasë në 6 muajt e kaluar



Burimi: Banka e Shqipërisë.


3.2-Aftësia paguese në 6 muajt e kaluar dhe pritshmëritë për 6 muajt e ardhshëm. Rreth 55% e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se aftësia e tyre paguese 'nuk ka ndryshuar' gjatë gjashtëmujorit të parë të 2020-ës dhe kjo peshë ka rënë me 13 pp krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës. Pjesa tjetër e të përgjigjurve, vlerësojnë në agregat *përkeqësim të aftësisë së tyre paguese (41% kanë deklaruar 'përkeqësim' dhe 4% kanë deklaruar 'përmirësim)*, si në krahasim me gjashtëmujorin kaluar dhe në krahasim me një vit më parë (Grafik 3.2), çka mund të jetë reflektim i përkeqësimit të përgjithshëm të parametrevave ekonomike në vend për shkak të pandemisë së Covid-19. Kjo është reflektuar dhe në pritjet pesimiste të familjeve lidhur me aftësinë e tyre paguese në të ardhmen. Kështu, 66% e familjeve huamarrëse *nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese (në rënie me 9 pp krahasuar me vrojtimin e kaluar) për gjysmën e dytë të vitit 2020*, ndërsa balanca neto e përgjigjeve të pjesës tjetër ka rezultuar – 8.4 pp, gjë që tregon se familjet presin *përkeqësim të mëtejshëm aftësisë së tyre paguese në 6 muajt e ardhshëm* (Grafik 3.3).

Grafik 3.2 Aftësia paguese në 6 muajt e kaluar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3.3 Pritshmëritë për aftësinë paguese në 6 muajt e ardhshëm



3.3-Pritshmëritë mbi marrjen e një huaje të re në 6 muajt e ardhshëm⁸. Rreth 58% e të përgjigjurve kanë deklaruar se 'nuk presin të marrin hua të re në 6 muajt e ardhshëm', ndërsa rreth 42% e të përgjigjurve (ose 453 familje), deklarojnë se e konsiderojnë në shkallë të ndryshme sigurie⁹ mundësinë për të marrë/rimarrë një hua të re dhe kjo peshë është rritur me 2 pp krahasuar me gjashtëmujorin kaluar dhe me 9 pp krahasuar me një vit më parë.

Si rezultat, *indeksi i mundësisë për të rimarrë një hua të re*¹⁰ ka rezultuar 0.182, duke shënuar rritje krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë, si dhe duke tejkaluar vlerën e mesatares afatgjatë të tij (Grafik 3.4). Kjo ecuri mund të sinjalizojë një rritje të kërkesës për huamarrje nga familjet gjatë gjysmës së dytë të vitit 2020.

Duke analizuar vetëm grupin e familjeve që *planifikojnë të marrin një hua të re (606 familje)*, rezulton se rreth 75% e tyre janë 'huamarrës të rinj', pra që nuk kanë hua të papaguar në momentin e intervistimit (Grafik 3.5)

⁸ Pyetja i drejtohet të gjithë kampionit prej 1210 familjesh dhe asaj i janë përgjigjur 1074 familje ose rreth 89% e totalit të kampionit.

⁹ Alternativat e dhëna janë: 'ka pak mundësi', 'ka shumë mundësi' dhe 'është e sigurt'.

¹⁰ Indeksi është llogaritur si mesatare e peshuar e % së përgjigjeve për secilën alternativë me koeficientët përkatës. Për përcaktimin e koeficientëve, intervali 0-1 është ndarë në 4 nën-intervale me gjatësi të barabartë 0.33. Koeficientët për secilën alternativë rezultojnë: 0 ('nuk ka asnjë mundësi'), 0.33 ('ka pak mundësi'), 0.66 ('ka shumë mundësi') dhe 1 ('është e sigurt'). Indeksi i përfituar merr vlera nga 0 në 1, ku sa më afër 0 të rezultojë vlera e indeksit, aq më e vogël është mundësia për të marrë hua të re dhe, sa më afër 1-shit, aq më e lartë mundësia për të marrë hua të re në 6 muajt e ardhshëm.


dhe kjo peshë është rritur me 12 pp në terma gjashtëmujorë dhe me 16 pp në terma vjetorë, duke konfirmuar rezultatin e mësipërm mbi mundësinë e rritjes së kërkesës për huamarrje nga individët.

Grafik 3.4 Indeksi i planifikimit të marrjes së një huaje në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3.5 Familjet që planifikojnë të marrin hua në 6 muajt e ardhshëm




4- Pasuria e familjeve

Kjo rubrikë përmban vetëm 2 pyetje mbi pronat e patundshme dhe pasurinë financiare të familjeve të intervistuar dhe i drejtohet të gjithë kampionit të familjeve. Rezultatet për 6-mujorin e parë të vitit 2020, paraqiten si më poshtë:


4.1-Pasuritë e patundshme të familjeve. Për këtë seksion pyetjesh kanë dhënë përgjigje 1080 familje, nga të cilat 95% kanë deklaruar se zotërojnë të paktën një pronë të patundshme. Familjet e përgjigjura deklarojnë se zotërojnë në total 1540 prona të patundshme të llojeve të ndryshme ku: 93% e tyre (1002 familje) zotërojnë '1-2 prona të patundshme' kryesisht të llojit 'shtëpi banimi' ose kombinim i një shtëpie banimi dhe një prone tjetër si 'tokë', 'dyqan', 'godinë' etj. Kjo peshë ka rënë krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë, respektivisht me 1 pp dhe 4 pp (Grafik 4.1).

Grafik 4.1 Shpërndarja e familjeve (total kampioni) sipas numrit të pronave që zotërojnë (në % ndaj totalit të familjeve të përgjigjura)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4.2 Shpërndarja e familjeve huamarrëse sipas numrit të pronave që zotërojnë (në % ndaj totalit të familjeve të përgjigjura)



Duke e fokusuar analizën vetëm në grupin e **familjeve huamarrëse** (gjithsej 251 familje huamarrëse), rezulton se familjet e përgjigjura (250 familje) deklarojnë gjithsej 362 prona të patundshme, ku 67% e tyre janë 'shtëpi', 29% janë 'toka' dhe pjesa tjetër janë 'dyqane' dhe 'godina' dhe lloje të tjera pronash.


Në shpërndarjen e familjeve huamarrëse sipas numrit të pronave që zotërojnë rezultojnë se: rreth 92% e tyre (232 familje) zotërojnë '1-2 prona të patundshme' në momentin e intervistimit, dhe kjo peshë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me vrotimin e kaluar dhe ka rënë me 3 pp krahasuar me një vit më parë. Në shumicën e rasteve këto prona janë një shtëpi banimi ose kombinimi i një shtëpie dhe një sipërfaqe toke. Vetëm 2% e familjeve huamarrëse (4 familje) deklarojnë se zotërojnë 'më shumë se dy prona' dhe kjo peshë ka rënë me 6 pp krahasuar me vrotimin e kaluar (Grafik 4.2).

4.2-Pasuritë financiare të familjeve¹¹. Nga përgjigjet e dhëna, rezultojnë se për periudhën e vrotuar, 42% e totalit të familjeve të kampionit të vrotuar (huamarrëse dhe johuamarrëse) dhe 60% e grupit të familjeve huamarrëse, deklarojnë se 'nuk zotërojnë asnjë lloj pasurie financiare' dhe të dyja këto pesha janë rritur respektivisht me 18 pp dhe 17 pp krahasuar me vrotimin e kaluar.

Duke analizuar vetëm pjesën e familjeve që kanë deklaruar pasuri financiare të formave të ndryshme (duke përfshirë rastet që 'nuk kanë asnjë lloj pasurie financiare'), rezultojnë se 'depozitat dhe/ose llogaritë bankare' vijojnë të mbeten lloji kryesor i investimit financiar, si në rastin e totalit të kampionit të familjeve (62% e rasteve të raportuara) dhe në rastin e familjeve huamarrëse (77% e rasteve të raportuara). Të dyja këto pesha kanë rezultuar në rënie krahasuar me 6-mujorin e kaluar (respektivisht me 8.8 pp dhe 8.2 pp) dhe krahasuar me një vit më parë (respektivisht me 5.1 pp dhe 3pp). Përdorimi i formave të tjera të investimit të pasurisë financiare, të përmbledhura në termin "investime të tjera"¹², ka rezultuar disi në rritje në rastin e totalit të kampionit të vrotuar në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë, por ka shfaqur prirje rënëse në rastin e grupit të familjeve huamarrëse. Nga ana tjetër, gjatë periudhës vëhet re një rritje e rasteve të raportuara të mbajtjes së kursimeve në formë *cash-i* (jashtë banke) si në rastin e totalit të kampionit dhe në grupin e familjeve huamarrëse.

Grafik 4.3 Shpërndarja e familjeve (total kampioni) sipas llojit të pasurisë financiare


(në % ndaj totalit të rasteve të deklaruara)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4.4 Shpërndarja e familjeve huamarrëse sipas llojit të pasurisë financiare

(në % ndaj totalit të rasteve të deklaruara)



Në ndryshim nga prirja e tre vrotimeve të kaluara, në këtë vrotim konstatohet një rritje e peshës së mbajtjes së pasurisë *jashtë sistemit* (ku përfshihen kursime në para të mbajtura jashtë banke ose të dhëna hua) kundrejt peshës së rasteve të mbajtjes së pasurisë financiare *brenda sistemit* (ku përfshihen depozita/llogari bankare dhe investime të tjera), si në terma gjashtëmujorë dhe në terma vjetorë. Kjo prirje vëhet re si në rastin e totalit të kampionit të familjeve dhe në rastin e grupit të familjeve huamarrëse.

¹¹ Pyetjes mbi pasuritë e financiare në pronësi të familjeve të intervistuar i janë përgjigjur 1080 familje.

¹² Në zërin "Investime të tjera" përfshihen rastet e investimeve në: bono thesari, sigurim jete, fond pensioni privat dhe aksione.